



NEON A.S
RR.XHANFISE KEKO, Nd.168 , H.1, CP. 1005
TIRANA, ALBANIA
TEL: +355 42 377 773 FAX: +355 42 347 770
E-MAIL: info@neon.al WEB: www.neon.al

**NEON RS ROOF STOP
(MONOTIKO IZOLUESE)
IZOLUES TARRACE DHE MURI
Skedë Teknike**

PËRSHKRIMI: NEON RS ROOF STOP është një izolues i shkëlqyer kundra lagështirës në tarrcë dhe në mur. NEON RS ROOF STOP është një bojë e bardhë e pregatitur nga një emulsion i tipit “polimer në ujë” e destinuar për lyerje terrace dhe muri përveç rezinës speciale që përmban për të krijuar shtesën izoluese të lagështisë, përmban në përqindje të caktuara ujë, mbushësa, pigmente e shtesa të tjera sikurse janë karbonat kalciumi, hidroksietilcelulozë, talk, poliksiloksane, poliakrilat amoni, hidroksid kaliumi, të cilët përmirësojnë vetitë e bojës. Gjithashtu përmban edhe Di izobutil Ftalat.
Referuar përbërësve të saj, në kushte optimale boja thahet 3 - 4 orë pas aplikimit, por 1 javë pas aplikimit, sipërfaqja mund të shkelet por kujdes nga takat dhe nga objektet të cilat në përgjithësi mund të krijojnë vrima mbi sipërfaqen.

FUSHA E PËRDORIMIT: NEON RS ROOF STOP është i përdorshëm si izolues i shkëlqyeshëm i lagështirës në tarraca dhe në mure.

NGJYRA: E bardhë.

PARAPËRGATITJA: Sipërfaqja që do të bojatset, duhet të pastrohet nga mbeturinat, pluhurat, yndyrnat apo nga shtresa të mëparshme të bojës, të lidhura dobët me sipërfaqet (shtresat e fryra).

PËRDORIMI: Presim anët e sipërfaqes me izolues të holluar në raportin 1 : 1 me ujë. Kur prerjet të jenë tharë mirë, kalojmë dorën e dytë.
Në qoftë se do të përdoret mbi tarracë, materiali duhet të jetë më i trashë, kështu që hollimi me ujë duhet të bëhet deri në atë masë që të mund të punohet me rrul ose me furçë.
Në qoftë se do të përdoret në mur, materiali duhet të jetë më i hollë, por gjithmonë duhet të kihet parasysh që të krijohet një film i trashë mbrojtës.
NEON RS ROOF STOP është i rezistueshëm në kushte të vështira atmosferike dhe në mënyrë elastike ndjek sipërfaqen ku është aplikuar. Garanton për një kohë të gjatë mbrojtjen kundra lagështirës.

KUJDES: Nuk lejohet aplikimi i izoluesit në sipërfaqe të njoma dhe në kushte të larta lagështie të mjedisit. Nuk lejohet përdorimi i izoluesit në temperaturë më të vogël se 5°C.
Pas përfundimit të lyerjes paisjet duhet të lahen menjëherë me ujë dhe sapun.

TE DHENAT TEKNIKE:

- Ngjyra.....E bardhë
- Imtësia.....10 – 30 μm
- Viskoziteti (30% ujë) Deep Cup 4.....35 – 45 sek
- Densiteti.....1.57 – 1.63 g/ml
- Fuqia mbuluese për përdorim tarrace0.6 L për 2 m²
- Fuqia mbuluese për përdorim muri0.6 L për 3 m²
- Mbetja e thatë..... $\leq 65 \%$
- Koha e tharjes.....3 - 4 orë

REZIKSHMËRIA: Bojrat me bazë ujore të “NEON sh.a” kanë përbërës që nuk klasifikohen si të rrezikshëm mbështetur në Direktivën 1999/45/EC.Megjithatë kontakti me acidet dhe në temperatura mbi 800°C, bën që të çlirohet dioksid karboni.

AMBALAZHIMI: Ambalazhimi bëhet në kova plastike 0.75 L, 3L, dhe 9L.

KUSHTET E RUAJTJES: Në ambalazh të mbyllur hermetikisht, të mbrojtur nga ngrica.